


**Shumica dërrmuese mendon që Shqipëria duhet të anëtarësohet në Traktatin e OKB-së për Ndalimin e Armëve Bërthamore (TPNW)**

---



# Konteksti dhe Metodologjia e Studimit

- Në janar 2021, ka hyrë në fuqi Traktati i OKB-së për Ndalimin e Armëve Bërthamore (TPNW). Një traktat gjithëpërfshirës që ndalon krijimin, zotërimin dhe përdorimin e armëve bërthamore.
- Qëllimi i traktatit është të ndalojë tërësisht armët bërthamore për shkak të pasojave të tyre katastrofike humanitare dhe të shërbeje si plotësues i traktateve ekzistuese ndërkombëtare si rregullatorë për armët bërthamore dhe ndalimin e armëve të shkatërrimit në masë. Shqipëria ende nuk i është bashkuar traktatit.



# Gjetjet e Studimit

## ANËTARËSIMI I SHQIPËRISË NË TRAKTATIT E OKB

- Rreth **98%** e të anketuarve mendojnë se Shqipëria **duhet t'i bashkohet traktatit**.
- Kur analizojmë rezultatet sipas zonës, gjinisë dhe rajonit, nuk vërehen dallime në opinionin e të anketuarve.

## SHQIPËRIA NDËR ANËTARËT E PARË TË NATO-S QË DO T'I BASHKOHET TRAKTATIT TË OKB


- Thuajse **90%** e të anketuarve mendojnë që Shqipëria duhet të jetë **ndër vendet e para** të NATO-s që do të anëtarësohet në Traktatin e OKB-së.
- Rreth 9% deklarojnë se Shqipëria nuk duhet të jetë ndër vendet e para të NATO-s që do të anëtarësohet dhe rreth 1% nuk kanë mendim ose refuzojnë të përgjigjen.

## PËRGATITJA E SHQIPËRISË NË RAST TË EMERGJENCËS SI REZULTAT I SHPËRTHIMIT TË ARMËVE BËRTHAMORE


- Rezultatet tregojnë se rreth **88%** e të anketuarve **nuk mendojnë se Shqipëria është e përgatitur** për të përballuar emergjencën që rezulton nëse armët bërthamore do të shpërthenin diku në botë.

# Profili i të Anketuarve


## Peshuar sipas moshës




Rajoni




Zona



Gjinia



Age



# Rezultatet e Studimit



# A mendoni se Shqipëria duhet t'i bashkohet Traktatit të OKB-së për Ndalimin e Armëve Bërthamore?

N=1100



98%

PO, shqipëria duhet t'i bashkohet traktatit të okb-së për ndalimin e armëve bërthamore


2%

JO, Shqipëria nuk duhet t'i bashkohet Traktatit të OKB-së për Ndalimin e Armëve Bërthamore

- Të pyetur nëse Shqipëria duhet të anëtarësohet në Traktatin e OKB-së për Ndalimin e Armëve Bërthamore, rreth 98% e të anketuarve mendojnë se Shqipëria duhet t'i bashkohet traktatit.

# A mendoni se Shqipëria duhet t'i bashkohet Traktatit të OKB-së për Ndalimin e Armëve Bërthamore?

N=1100



- Kur analizojmë rezultatet sipas zonës, gjinisë dhe rajonit, nuk vërehen dallime në opinionin e të anketuarve.

# A mendoni se Shqipëria duhet të jetë ndër anëtarët e parë të NATO-s që do t'i bashkohet Traktatit të OKB -së për Ndalimin e Armëve Bërthamore?

N=1073



90%

PO, Shqipëria DUHET të jetë ndër anëtarët e parë

9%


JO, Shqipëria NUK DUHET të jetë ndër anëtarët e parë

- Për më tepër, të anketuarit u pyetën nëse Shqipëria duhet të jetë ndër vendet e para të NATO-s që do të anëtarësohet apo jo.
- Rezultatet tregojnë se 90% e të anketuarve mendojnë që Shqipëria duhet të jetë ndër vendet e para të NATO-s që do të anëtarësohet në Traktatin e OKB-së.
- Rreth 9% deklarojnë se Shqipëria nuk duhet të jetë ndër vendet e para të NATO-s që do të anëtarësohet dhe rreth 1% nuk kanë mendim ose refuzojnë të përgjigjen.

*\*Vetëm ata që deklaruan se Shqipëria duhet ti bashkohet Traktatit të OKB-së për Ndalimin e Armëve Bërthamore*

# A mendoni se Shqipëria duhet të jetë ndër anëtarët e parë të NATO-s që do t'i bashkohet Traktatit të OKB -së për Ndalimin e Armëve Bërthamore?

N=1073



- Kur ndahen rezultatet sipas urbanitetit, gjinisë dhe rajonit, ka pak dallime në mendimin e të anketuarve.
- Rreth 7% më pak të anketuar nga zona urbane mendojnë se Shqipëria duhet të jetë ndër të parat vende të NATO-s që do t'i bashkohet (87% Urban kundrejt 94% Rural).
- Për më tepër, rreth 88% e të anketuarve femra mendojnë se Shqipëria duhet të jetë ndër të parat, krahasuar me 92% të të anketuarve meshkuj që mendojnë të njëjtën gjë.
- Për sa i përket ndarjes rajonale, rajoni Juglindor dhe ai Qendror janë më pak të prirur të mendojnë se Shqipëria duhet të jetë ndër anëtarët e parë që do të anëtarësohet (85% dhe 88% respektivisht, krahasuar me 91% për rajonin Jugperëndimor dhe 95% për rajonin Verior).

\*Vetëm ata që deklaruan se Shqipëria duhet ti bashkohet Traktatit të OKB-së për Ndalimin e Armëve Bërthamore

# Aktualisht, a mendoni se Shqipëria është e përgatitur për të trajtuar emergjencën që mund të rezultojë nga shpërthimi i armëve bërthamore diku në botë?

N=1100



8%

PO, është e përgatitur

88%

JO, nuk është e përgatitur


4%

Nuk e di

- Rezultatet tregojnë se rreth 88% e të anketuarve nuk mendojnë se Shqipëria është e përgatitur për të përballuar emergjencën që rezulton nëse armët bërthamore do të shpërthenin diku në botë.
- Vetëm 8% e të anketuarve deklarojnë se Shqipëria është e përgatitur dhe 4% e të anketuarve nuk kanë mendim ose refuzojnë të përgjigjen.

# Aktualisht, a mendoni se Shqipëria është e përgatitur për të trajtuar emergjencën që mund të rezultojë nga shpërthimi i armëve bërthamore diku në botë?


N=1100



- Rreth 6% më shumë të anketuar nga zona urbane mendojnë se Shqipëria nuk është e përgatitur të përballojë emergjencën që rezulton nëse armët bërthamore do të shpërthenin diku në botë (91% urbane kundrejt 85% rurale). Duhet theksuar se për zonat rurale përqindja e atyre që nuk kanë një mendim ose refuzojnë të përgjigjen është më e lartë se në zonat urbane.
- Për sa i përket ndarjes rajonale, rreth 94% e të anketuarve nga rajoni Juglindor mendojnë se Shqipëria nuk është e përgatitur.
- Nuk ka dallime të rëndësishme kur rezultatet ndahen sipas gjinisë.


# Cilën parti politike keni më shumë gjasa të simpatizoni?

*N=1100*



Duke mbajtur në konsideratë termat "i majtë" dhe "i djathtë" kur ju shprehni pikëpamjet tuaja politike, ku do ta vendosnit veten tuaj në një shkallë nga 1 deri në 10 ku 1=Plotësisht majtas dhe 10=Plotësisht djathtas?

N=1100



*Sponsori i studimit:* **Pathways to Peace**

*Drejtor Ekzekutiv i Projektit:* **Rinor Jani**

*Kontakt:* **info@pathwaystoppeace.org**

*Bashkë-sponsorizuar nga **Nuclear Age Peace Foundation** dhe **Fondacioni “Së Bashku”***